




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integrimi Evropiane

Mitrovicë, 01.04.2026

**FTESË PUBLIKE PËR TRAJNIM DHE PRAKTIKË NË PUNË ME
PAGESË PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA.**

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integrimi Evropiane duke u bazuar në Rregulloren Komunale NR – 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, i fton personat me aftësi të kufizuara të grupmoshave 18-45 vjeç të aplikojnë për skemën trajnim dhe praktikë në punë në Biznese, OJQ dhe Institucione Publike.

Kohëzgjatja e trajnimit dhe praktikës në punë do të jetë 6 (gjashtë) muaj, jo më shumë se 20 (njëzet) orë në javë, dhe e njëjta ofrohet në bazë të Planit të Drejtorisë.

Të përzgjedhurit për trajnim dhe punë praktike me pagesë do të marrin një kompensim në formë të ndihmës financiare prej 250.00€, e cila pagesë bëhet me qëllim të mbulimit të shpenzimeve të trajnimit apo praktikës, i cili kompensim bëhet në xhironlogarinë e përfituesit.

Dokumentet e nevojshme për Aplikim:

- Aplikacioni - (Formularin e aplikimit mund ta merrni në zyrën e bizneseve apo mund ta shkarkoni në formë elektronike në web faqen zyrtare të Komunës së Mitrovicës së Jugut);
- I papunësuar duhet të jetë i regjistruar si punëkërkuar të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit pas diplomimit - (Vërtetimi nga zyra e punësimit);
- Dëshminë që është shtetas/e i Republikës së Kosovës, si dhe është banor rezident i Komunës së Mitrovicës së Jugut - (Letërnjoftimi, certifikata e shtetësisë dhe certifikata e vendbanimit);
- Dëshminë mbi përfundimin e shkollimit të mesëm apo të lartë - (Diplomën e shkollë së mesme apo fakultetit);
- Dëshmi mbi aftësinë e kufizuar (vendim apo vërtetim i lëshuar nga organi kompetent që dëshmon statusin e personit në fjalë);
- Lista e punëkërkuarve merret në Institucionin përkatës për verifikim.

I papunësuar i regjistruar nuk mund të jetë përfitues i punës praktike me pagesë më shumë se 1 (një) herë brenda 3 (tre) viteve.

Thirrja publike qëndron e publikuar 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e shpalljes.

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht ose me postë, në adresën e mëposhtme:

Komuna e Mitrovicës


Kati përdhësë, zyra pritëse

Rruga "Bedri Gjinaj", 40,000 Mitrovicë

Kërkesat të cilat nuk kompletohen, dhe në mungesë të dokumentacionit, të njëjtat do të refuzohen nga Komisioni Vlerësues

Të gjitha çështjet që lidhen me ftesën publike mund të sqarohen në zyrat e DEZHTIE-së në Komunën e Mitrovicës.

Gani Rrustemi



Drejtor i Drejtorisë për Ekonomik, Zhvillim,
Turizëm dhe Integritim Evropian





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-113/04-0017212-2/26 dt. 03.04.2026
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenet 14 dhe 27 të Rregullores Komunale Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, dhe Kërkesën Nr. 01-113/04-0017212/26, dt. 01.04.2026 të Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

- 1. Aprovohet** Kërkesa Nr. 01-113/04-0017212/26, dt. 01.04.2026 e Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian, dhe i lejohet shpallja e Thirrjes Publike dhe shfrytëzimi i mjeteve financiare nga buxheti i Komunës së Mitrovicës së Jugut, në shumë prej 30,000.00 € (tridhjetë mijë euro), me qëllim të realizimit të projektit “Trajnim dhe Praktikë në Punë për Personat me Aftësi të Kufizuara” sipas Planit të Punës së kësaj Drejtorie për vitin 2026.
- 2.** Mjetet e lejuara sipas pikës 1 të këtij Vendimi do të shfrytëzohen për realizimin e projektit të Drejtorisë në fjalë “Trajnim dhe Praktikë në Punë për Personat me Aftësi të Kufizuara”, dhe me qëllim të mbulimit të shpenzimeve për 20 (njëzetë) praktikantë për periudhën kohore prej 6 (gjashtë) muaj, ku pagesa mujore për 1 (një) praktikant do të jetë në shumë prej 250.00 € (dyqind e pesëdhjetë euro).
- 3.** Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian obligohet që të zhvillojë procedurat për përzgjedhjen e praktikantëve konform kriterëve dhe dispozitave të Rregullores Komunale Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve dhe kriterëve të Thirrjes Publike, si dhe dispozitave tjera ligjore nga fusha përkatëse.
- 4.** Thirrja Publike për realizimin e këtij projekti e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi, së bashku me kriteret do të publikohen në web faqen e Komunës, dhe e njëjta do të qëndrojë e hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga momenti i publikimit.
- 5.** Në përputhje me Rregulloren Komunale Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, dhe me propozimin e Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian, Kryetari i Komunës do të formojë Komisionin Vlerësues i cili do të bëjë vlerësimin e



aplikacioneve në përputhje me kriteret e përcaktuara me Thirrjen Publike dhe në këtë Rregullore.

6. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritime Evropiane në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, ndërsa mjetet e parapara sipas këtij Vendimi paguhet nga kategoria ekonomike: Subvencione dhe Transfere të Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritime Evropiane.
7. Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritime Evropiane është e obliguar të njoftojë përfituesit për kohën dhe datën e nënshkrimit të Kontratave.
8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Kryetari i Komunës

Faton PEÇI

Shtojcë:

Kërkesa Nr. 01-113/04-0017212/26, dt. 01.04.2026, të Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritime Evropiane; Thirrja Publike e DEZHTIE-së.

Ti dorëzohet:


- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritime Evropiane
- 1x1 Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- 1x1 Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian

FORMULAR PËR APLIKIM PËR TRAJNIM DHE PRAKTIKË NË PUNË

Informata të përgjithshme për të papunësuarin			
1	Emri (emri i prindit) Mbiemri		
2	Mbiemri i vajzërisë		
3	Numri personal		
4	Ditëlindja		
5	Gjinia		
6	Adresa e vendbanimit		
7	Fshati/ Komuna		
8	Numri i telefonit		
9	E-mail adresa		
10	Kopja e letërnjoftimit		
11	Nivelet e shkollimit që kenikryer.	Master/MBA	Viti _____
		Bachelor	Viti _____
		Shkollë e mesme	Viti _____
12	Programi i Studimit		
13	Nota mesatare nga studimet (për të diplomuarit në nivel të lartë të shkollimit)		
14	Dëshmia e Certifikates /Diplomes	PO JO	
16	A jeni shfrytëzues i asistencës sociale?	PO JO	
19	Nënshkrimi i Aplikuesit		_____ data : __/__/2025